



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
Nr. 33 datë 31.05.2024

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË ZBATIMIT  
TË BUXHETIT TË VITIT 2023 TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 44, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 51 e vijues të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes , paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” , të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar, Udhëzimin nr 31 date 13.12.2023 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2023” . VKB nr.23 datë 29.04.2024 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të bashkisë Shkodër”, sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023, të bashkisë Shkodër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Oltion LUKA**



Miratuar me 39 vota

Vota Pro 32

Vota Kunder 11

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.06.2024